



PROGRAMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2016



► **MASA 103:**
INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN
DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE



Përmbajtja

1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINACIARE PËR KËTË MASË	3
1.1. Hyrje	3
1.2. Objektivat e masës	3
1.3. Mjetet financiare	3
1.4. Përkufizimet kryesore	4
1.5. Objektivat specifike	5
2. PËRKRAHJA PUBLIKE DHE APLIKUESIT E PRANUESHËM	8
3. LISTA KONTROLLUESE PËR PËRZGJEDHJE MJEDISORE	10
4. INVESTIMET E PRANUESHME	10
5. KRITERET E VECANTA TE PRANUESHMERISE	11
6. KRITERET E PËRZGJEDHJES.....	12
7. RREGULLAT PËR SHPENZIMET E PAPRANUESHME	15
8. PROCEDURAT E APLIKIMIT	15
8.1. Përmbajtja e aplikacionit	15
8.2. Dorëzimi i aplikacioneve dhe afati i fundit.....	16
9. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI	16
10. LISTA E SHTOJCAVE	20
Shtojca Nr. 1 Formulari i aplikimit për Masën 103.....	21
Shtojca Nr. 2 Modeli për përgatitjen e Planit të Biznesit	28
Shtojca Nr. 3 Kontrata e AZHB-së me përfitues dhe Procedurat e Prokurimit.....	35
Shtojca Nr. 4 Lista e shpenzimeve të pranueshme	46
Shtojca Nr. 5 Standardet Minimale Kombëtare	54
Shtojca Nr. 6 Kërkesa për Pagesë	60
Shtojca Nr. 7 Letra Informuese	65
Shtojca Nr. 8 Forma e Ankesës për agropërpunues	66
Shtojca Nr. 9 Zyrrat Rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë	67
Shtojca Nr. 10 Drejtoritë komunale të bujqësisë	68
Shtojca Nr. 11 Indikatorët e ndikimit, Pjesa financiare e planit të biznesit (në Excel).....	70
Shtojca Nr. 12 Pjesa financiare e planit të biznesit (në Excel).....	76
Shtojca Nr. 13 Kodi i etikës për kompanitë këshilluese.....	76
Shtojca Nr. 14 Promovimi.....	77
Shtojca Nr. 15 Lista kontrolluese për përzgjedhje mjedisore.....	78

PROGRAMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL
MASA 103: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE

1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINACIARE PËR MASËN 103

1.1. HYRJE

Udhëzuesi për aplikues ka për qëllim t'u ndihmojë aplikuesëve në përgatitjen e aplikacioneve të tyre, t'i qartësojë kushtet e pranueshmërisë, kriteret e përgjithshme, kriteret e vecanta, kriteret tjera të pranueshmërisë, sistemin e poentimit, investimet e pranueshme, dokumentet e nevojshme për aplikim, vlerësimin e projekteve, njoftimin e aplikuesit për rezultatet e vlerësim-it, procedurat e prokurimit, ndëshkimet në rast të parregullsive apo tentimeve për mashtrim si dhe çështjet tjera me rëndësi për implementimin e Masës 103.

Roli i Udhëzuesit për aplikues (më tutje Udhëzuesi) është të sqarojë në detaje dispozitat e paraqitura në Masën 103 dhe jo të përsëris atë, prandaj ky nuk e zëvendëson masën por duhet lexuar (bashkë me shtojcat) me qëllim të shmangies së gabimeve gjatë aplikimit.

Masa është dokument që paraqet objektivat e përkrahjes publike në investimet private, përmes granteve, dhe këtë e bënë me një gjuhë teknike. Masa 103 synon t'i përkrahë investimet në industrinë e përpunimit të ushqimit në katër nën sektorë: përpunim të qumështit, përpunim të mishit, përpunim të pemëve dhe perimeve dhe prodhim të verës. Masa është përgatitur nga personeli i Autoritetit Menaxhues, duke u bazuar në studime të pavarura për sektorë, këshillime me palët e interesit dhe përkrahje nga ekspertë ndërkombëtarë.

1.2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË MASËS

- ▶ Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit, përmes rritjes së produktivitetit dhe futjes së teknologjive dhe produkteve të reja;
- ▶ Përkrahja e ndërmarrjeve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së dhe përmirësimet në mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe cilësinë e produkteve, mirëqenien e kafshëve dhe gjurmueshmërinë e zinxhirit të ushqimit dhe menaxhimin e mbeturinave;
- ▶ Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave;
- ▶ Forcimi i lidhjeve me prodhimin primar.
- ▶ Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

1.3. MJETET FINACIARE PËR KËTË MASË

Nr.	Gjithsej për vitin 2016 për masën 103	5,000.000.00 €	100%
1	103.1 Përpunimi i qumështit	1,200.000.00 €	24%
2	103.2 Përpunimi i mishit	1,400.000.00 €	28%
3	103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	1,600.000.00 €	32%
4	103.3a Prodhimi i verës	800.000.00 €	16%

1.4. PËRKUFIZIMET KRYESORE

Shkalla e përkrahjes publike – është pjesëmarrja (e shprehur në përqindje) e mjeteve publike në shpenzimet e pranueshme;

Aplikues – janë personat juridikë që i plotësojnë kriteret e pranueshme, të prezantuara në këtë dokument dhe të cilët paraqesin kërkesë për të përfituar nga fondet e zhvillimit rural;

Aplikacion – dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;

Përfitues – personi juridik i cili është përzgjedhur përfitues pas vlerësimit të aplikacionit dhe që ka nënshkruar kontratë me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB);

Thirrja për aplikim – njoftimi publik për aplikimin për projektet e zhvillimit rural;

Kontrata – nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të aplikuesit të përzgjedhur dhe AZHB, sipas modelit të paraqitur në Shtojcën Nr. 3 të këtij Udhëzuesi;

Investimet e pranueshme – janë investimet që përkrahen me mjete publike, si në Shtojcën Nr. 4.

Periudha e monitorimit Ex-post – nënkupton periudhën kohore prej 5 vjetësh pas përfundimit të investimit, gjatë së cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave ai është përzgjedhur për financim;

Përkrahja publike – nënkupton ndihmën financiare për implementimin e projekteve të zhvillimit rural sipas investimet e pranueshme, të dhënë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);

Autoriteti Menaxhues – nënkupton entitetin publik brenda MBPZHR-së, i organizuar si departament, me përgjegjësi kryesore në hartimin dhe monitorimin e Programit të Zhvillimit Rural (PZHR);

Masa – nënkupton dokumentin teknik që paraqet njësinë bazë të PZHR dhe pjesët kryesore të saj ku janë të paraqitura kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhje së aplikuesve. Masa ka buxhetin për realizimin e objektivave dhe zbatohet përmes thirrjes për aplikim dhe procesit të vlerësimit të projekteve.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë - është organi kompetent për zbatimin e PZHR (<http://azhb.rks-gov.net/>) me përgjegjësi kryesore në vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve si dhe pagesën e shpenzimeve sipas procedurave të parapara;

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-20 – është dokument teknik, i cili përcakton masat e zhvillimit rural, logjikën e intervenimit dhe ndikimin e pritur të projekteve të zhvillimit rural;

Projekt – investimi i planifikuar i dorëzuar nga aplikuesi;

Periudha e implementimit të projektit – nënkupton kohën prej nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri tek ekzekutimi i pagesës së fundit nga AZHB- ja;

Përzgjedhja – nënkupton përcaktimin e numrit të pikëve për aplikuesit e pranueshëm, radhitjen e tyre në listë sipas pikëve dhe deklarimi i tyre "i përzgjedhur për financim" dhe shpërndarje të mjeteve financiare duke filluar nga ata në krye të listës.

Zgjerimi - për qëllime të këtij programi, fjala zgjerim nënkupton zgjerimin e objektit ekzistues.

1.5. OBJEKTIVAT E VEÇANTA

PËRPUNIMI I QUMËSHTIT

Objektivat e veçanta për sektorin e përpunimit të qumështit janë:

- ▶ Implementimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e qumështit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, ruajtja e mjedisit, etj.);
- ▶ Modernizimi i linjave të përpunimit të qumështit dhe objekteve të tjera përcjellëse;
- ▶ Futja e prodhimeve të reja ose diversifikimi i prodhimeve në industrinë e qumështit;
- ▶ Përmirësimi i marketingut të qumështit dhe prodhimeve të tij;
- ▶ Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

INVSTIMET E PRANUESHME PËR PËRPUNIMIN E QUMSHTIT

- ▶ Investimet në rinovim / zgjerim dhe modernizim të qumështoreve;
- ▶ Investimet në ndërtim të qumështoreve të reja të cilat në kohën e aplikimit janë në kategorinë "C" ose "D";
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujit;
- ▶ Investimet në ndërtimin dhe pajisjen e pikave grumbulluese të qumështit;
- ▶ Investimet në mjete transportuese të specializuara;
- ▶ Investimet në pajisje për prodhime të reja dhe paketime moderne;
- ▶ Pajisje të IT-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- ▶ Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- ▶ Investimet në pajisje për ftohje;

PËRPUNIMI I MISHIT

Objektivat e veçanta për sektorin e përpunimit të mishit janë:

- ▶ Implementimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e mishit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, ruajtja e mjedisit, etj.);
- ▶ Futja e linjave të reja të përpunimit të mishit;
- ▶ Futja e prodhimeve të reja ose diversifikimi i prodhimeve në industrinë e mishit;
- ▶ Modernizimi i thertoreve duke përfshirë therjet e specializuara (për ripërtypësit e vegjël);
- ▶ Përmirësimi i marketingut të mishit dhe produkteve të mishit;
- ▶ Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

INVSTIMET E PRANUESHME PËR PËRPUNIMIN E MISHI

THERTORET

- ▶ Investimet në rinovim / zgjerim dhe modernizim të thertoreve, përfshirë depot ftohëse;
- ▶ Investimet në ndërtim të thertoreve të reja të cilat në kohën e aplikimit janë në kategorinë "C" ose "D";
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujit;
- ▶ Pajisje për rjepje dhe përgatitje (rexhje) të lëkurave;
- ▶ Pajisje për thertore, duke përfshirë pajisje për ftohje;
- ▶ Kamionë specialë për bartjen e kafshëve të gjalla që i plotësojnë kërkesat për mirëqenien e kafshëve;
- ▶ Stalla për vendosjen e kafshëve para therjes;
- ▶ Kamionë frigoriferë për bartjen e mishit;
- ▶ Makina, pajisje dhe depo për trajtim të mbetjeve dhe nënprodukteve;
- ▶ Pajisje të IT-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- ▶ Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

NJËSITË PËR PËRPUNIMIN E MISHIT

- ▶ Investimet në rinovim / zgjerim dhe modernizim të objekteve ekzistuese, përfshirë depot ftohëse bashkë me pajisje;
- ▶ Investimet në ndërtim të objekteve të reja për përpunim për ndërmarrjet të cilat në kohën e aplikimit janë në kategorinë "C" ose "D";
- ▶ Investimet në pajisje për përpunim të mishit;
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujit;
- ▶ Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- ▶ Investimet për pajisje për ftohje dhe ngrirje për ruajtjen e prodhimeve të gatshme;
- ▶ Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme;
- ▶ Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- ▶ pajisjet për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët;

PËRPUNIMI I PEMËVE, PERIMEVE DHE PRODHIMI I VERËS

Objektivat e veçanta për sektorin e pemëve, perimeve dhe prodhimin e verës janë:

- ▶ Implementimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së (higjiena, siguria ushqimore, cilësia, etj.);
- ▶ Përmirësimi i teknologjisë së përpunimit, si dhe modernizimi i objekteve të tjera përcjellëse (depot ruajtëse / ftohëse) duke futur pajisje/teknologji të reja;
- ▶ Diversifikimi i prodhimeve;
- ▶ Përmirësimi i marketingut;
- ▶ Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve

INVESTIMET E PRANUESHME PËR NENMASEN E PERPUNIMIT TE PEMËVE DHE PERIMEVE

- ▶ Investimet në ndërtim / rinovim dhe modernizim të objekteve për përpunim;
- ▶ Investimet në linja për konservim / pasterizim të pemëve dhe perimeve;
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- ▶ Investimet në objekte dhe pajisje për trajtim pas vjeljes, për tharje, për klasifikim dhe për depozim;
- ▶ Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit dhe pajisje të tjera të specializuara;
- ▶ Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- ▶ Investimet në pajisje për zinxhirin ftohës, duke përfshirë depo për ftohje dhe ngrirje, tunele të ngrirjes, mjete transportuese me frigorifer dhe pajisje të tjera të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë në zinxhirin e ftohjes;
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujit;
- ▶ Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- ▶ Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme, me ftohje dhe pa ftohje;
- ▶ Pajisje të IT-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;

INVESTIMET E PRANUESHME PËR PRODHIMIN E VERËS

- ▶ Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i objekteve për prodhimin dhe përpunimin e verës;
- ▶ Investimet në pajisje për përpunimin e verës;
- ▶ Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- ▶ Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit dhe pajisje të tjera të specializuara;
- ▶ Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- ▶ Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- ▶ Pajisje të IT-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim.

SHKALLA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Intensiteti i përkrahjes:

- ▶ Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 30,000 €;
- ▶ Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 400,000 €;
- ▶ Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit;
- ▶ Për investimet në trajtimin e mbetjeve rritet intensiteti i përkrahjes publike për 10% - vetëm për pjesën e investimit për këtë qëllim përkrahja publike është 60%;
- ▶ Pagesa për Masën 103 bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.

2. APLIKUESIT E PRANUESHËM PËR TË GJITHA NËNMASAT

- ▶ Aplikuesit duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës.
- ▶ Aplikuesit duhet të jenë persona juridik dhe të regjistruar në Regjistrin e Fermës.
- ▶ Aplikuesit duhet të jenë pagues të rregullt të taksave mbi bizneset.
- ▶ Ndërmarrjet e përpunimit të qumështit, mishit, përpunimit të pemëve dhe perimeve si dhe të prodhimit të verës duhet të jenë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare.

Një ndërmarrje mund të përbëhet nga një ose më shumë objekte (njësi lokale të prodhimit).

Kujdes: TVSH është shpenzim i papranueshëm dhe atë e paguan përfituesi! Edhe shpenzimet tjera të papranueshme do të paguhet nga përfituesi.

Çdo tentim për mashtrim, si: falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe mund të ketë ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa.

PRANUESHMËRIA E APLIKUESËVE DHE APLIKACIONEVE TË TYRE

Të gjithë aplikuesit i nënshtrohen kontrollit të pranueshmërisë. Nëse konstatohet se aplikuesi është i papranueshëm, aplikacioni refuzohet. Pranueshmëria e aplikuesit kontrollohet në bazë të dokumenteve të kërkuara dhe atyre të dorëzuara. Pas kontrollimit të pranueshmërisë së aplikuesve, vazhdohet me kontrollin e pranueshmërisë së aplikacioneve. Aplikacionet e cilësuar si të papranueshme nuk i nënshtrohen vlerësimit.

Kujdes: Të gjitha kriteret e pranueshmërisë duhet të ruhen për së paku 5 vjet pas implementimit të projektit, aq sa zgjatë periudha monitoruese nga AZHB. Mosrespektimi i këtij kriteri nënkupton kthimin e mjeteve të financuara publike dhe ndëshkim shtesë sipas legjislacionit në fuqi. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë do të bëjë kontrolle periodike me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike.

Përfituesit përfundimtarë, para kërkesës për pagesën e fundit, janë të obliguar t'i deklarojnë ndryshimet e kapaciteteve prodhuese.

Një aplikant mund të dorëzojë vetëm një projekt në vit në kuadër të këtij programi.

Aplikacioni konsiderohet i plotë vetëm nëse shoqërohet me të gjitha dokumentet e kërkuara në Shtojcën nr. 1.) - Lista e dokumenteve të dorëzuara.

Aplikuesi duhet të nënshkruajë një deklaratë me të cilën zotohet se nuk do ta ndërrojë qëllimin e investimit edhe pesë vjet pas implementimit të investimit. Përfituesi duhet ta mbajë investimin në kushte të mira. Aplikuesi nuk guxon të ketë obligime fiskale ndaj shtetit (obligime ndaj ATK-së) dhe nuk guxon të ketë obligime financiare ndaj MBPZHR.

Kujdes: Përfituesit janë të obliguar të shlyejnë detyrimet tatimore të aplikueshme edhe gjatë implementimit të projektit dhe periudhës pesë vjeçare pas implementimit, aq sa zgjat periudha monitoruese. Përfituesit që nuk e përmbushin këtë kriter, obligohen t'i kthejnë paratë e perfutuara publike dhe do të ndëshkohen në përputhje me legjislacionin në fuqi!

Aplikuesi duhet ta dorëzojë një plan të biznesit sipas modelit të paraqitur në Shtojcën nr.2 të këtij Udhëzuesi.

KRITERET E TJERA TË PRANUESHME PËR PËRFITUESIT

Në rastin e projekteve të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet t'i dorëzojnë:

- ▶ Kopjet e skicave të objektit dhe një parallogaritje të shpenzimeve të materialit dhe punëve të parapara;
- ▶ Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- ▶ Fletën poseduese për parcelën ku do të bëhet investimi;
- ▶ Pëlqimin nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit / zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit.

Ndërsa, para kërkesës për pagesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet ta dorëzojë:

- ▶ Lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës. Nuk kërkohet për projektet e rinovimit;
- ▶ Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj;
- ▶ Përfituesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme;
- ▶ Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB;
- ▶ Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2016 nuk bën të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast të zbulimit se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njejtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin;
- ▶ Përfituesi, i cili ka aplikuar në MBPZHR dhe institucione tjera publike apo në zyrën e BE-së në Kosovë dhe projekti i tij përzgjedhet për financim nga ndonjëri prej institucioneve, duhet menjëherë të informojë MBPZHR / AZHB apo institucionet tjera përkatëse;
- ▶ Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe t'i dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga për së paku muajin e fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjat periudha monitoruese.

Kujdes: Aplikuesit nuk mund ti ipet nje projekt i ri nese ka qen perfitues i vitit paraprak dhe nuk e ka perfunduar investimin.

3. LISTA KONTROLLUESE PËR PËRZGJEDHJE MJEDISORE

Me rastin e përzgjedhjes së përfituesve, para nënshkrimit të kontratave për financim të projekteve për zhvillim rural, projektet e përzgjedhura do t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit mjedisor, sipas Listës Kontrolluese për Përzgjedhje Mjedisore (Shtojca Nr. 15). Lista kontrolluese do të plotësohet nga AZHB duke dhënë informata shtesë për rubrikën "Karakteristikat specifike" për t'i sqaruar përgjigjet e dhëna. Nëse një apo më shumë përgjigje në listën kontrolluese është pozitive (PO), atëherë projekti do të ketë ndikim në mjedis, dhe si i tillë kërkon përgatitjen e Planit për Menaxhim Mjedisor (PMM). Masat zbutëse të parashikuara në listën kontrolluese do të jenë pika udhëzuese për përgatitjen e PMM-së. Procesi i aprovimit të projektit kërkon që të gjitha masat zbutëse të propozuara të pranohen dhe të miratohen për zbatim nga ana e aplikuesit. Përgatitja e PMM-së do të jetë obligim i vetë aplikuesit, ndërsa shpenzimet për përgatitjen e tij do të konsiderohen si shpenzime administrative.

4. INVESTIMET E PRANUESHME

Investime të pranueshme janë:

- ▶ Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i objekteve;
- ▶ Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, duke përfshirë programe kompjuterike të nevojshme për funksionimin e linjave të prodhimit apo funksioneve të tjera primare që ndërlidhen me aktivitetet kryesore të ndërmarrjes;
- ▶ Të pranueshme janë investimet në nënsektorët e përpunimit të qumështit, të mishit, të pemëve dhe të perimeve, si dhe prodhimit të verës, përfshirë edhe shpenzimet e marketingut për promovimin e tyre;
- ▶ Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nënmasat e Masës 103 janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve, etj., për promovim të produkteve, por jo edhe për shpërndarje të tyre. Po ashtu, shpenzime të pranueshme të marketingut janë edhe prodhimi i audio dhe video-spotëve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale;
- ▶ Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 10,000 €;
- ▶ Shpenzimet e tjera të ndërlidhura me projektin, siç janë: shpenzimet për arkitekt, për inxhinier dhe shpenzimet për studime parapake, si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme por jo më shumë se 15,000 €, kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme për projekt, por jo më shumë se 5,000 €;
- ▶ Shpenzimet administrative, edhe pse ndodhin para nënshkrimit të kontratës, janë të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është përzgjedhur dhe është kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Kujdes: Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe t'i dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga për së paku muajin e fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjat periudha monitoruese.

5. KRITERET E VECANTA TE PRANUESHMERISE

NENSEKTORËT E PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT DHE TË MISHIT

Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet të cilat kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku 2 vjet para datës së aplikimit dhe janë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, sipas kategorizimit të ndërmarrjeve për përpunim të ushqimit.

- ▶ **Kategoria "A" = shkallë e ultë e rrezikut**
- ▶ **Kategoria "B" = shkallë e mesme e rrezikut**
- ▶ **Kategoria "C" = shkallë e lartë e rrezikut**
- ▶ **Kategoria "D" = shkallë shumë e lartë e rrezikut**

Aplikuesit e kategorisë "A dhe B" nuk janë të pranueshëm 137m në rast të ndërtimit dhe zgjerimit të objekteve.

Aplikuesit e kategorisë "C" janë të pranueshëm për ndërtim të ri me kusht të mbylljes së objektit ekzistues ose rinovim të objektit ekzistues.

Aplikuesit e Kategorisë "D" janë të pranueshëm vetëm në rast të ndërtimit të objektit të ri dhe mbylljes së objektit ekzistues. Këta aplikues mund të aplikojnë edhe në pajisje dhe në investime tjera.

NENSEKTORËT E PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE

Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet të cilat kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku 2 vjet para datës së aplikimit dhe janë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Në rast të investimit në qendrat grumbulluese dhe paketuese, kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jetë së paku 1000 m³ të prodhimit.

NËNSEKTORI I PRODHIMIT TË VERËS

Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet e regjistruara në Regjistrin e Prodhuesve të Verës. Të drejtë aplikimi kanë prodhuesit e verës që së paku 50 % të lëndës së pare (rrushit) e sigurojnë nga prodhuesit e tjerë (jo prodhim vetanak). Ky riter nuk vlen për prodhuesit e verës që kanë në pronësi mbi 50 ha me vreshta. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se e kanë deklaruar prodhimin vjetor të verës dhe dtoqeve të ngelura.

Pagesa për Masën 103 bëhet në dy këste, pjesa e pare e përkrahjes publike në vlerë prej 50 % bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50 %, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.

Të gjitha investimet duhet të jenë pjesë e listës së shpenzimeve të pranueshme, si në Shtojcën nr. 4.

SHPENZIMET MINIMALE DHE MAKSIMALE PËR PROJEKTE

- ▶ Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 30,000 €;
- ▶ Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 400,000 €;
- ▶ Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit;
- ▶ Për investimet në trajtimin e mbetjeve rritet intensiteti i përkrahjes publike për 10% - vetëm për pjesën e investimit për këtë qëllim përkrahja publike është 60%;

PROMOVIMI I PËRKRAHJES

- ▶ Të gjithë përfituesit duhet t'i respektojnë rregullat e promovimit të përcaktuara nga institucioni financues.
- ▶ Të gjithë përfituesit e granteve nga Programi I Zhvillimit Rural, para kërkesës për pagesën e fundit, në vendin e investimit, duhet të vendosin një tabelë siç është paraqitur në Shtojcën nr. 13. Kjo tabelë duhet të vendoset në vend të dukshëm, me madhësi: 100 cm x 50 cm, e punuar nga plastikë e fortë, e shkruar me ngjyrë të qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike.

6. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Tabela 1: Nënmasa e përpunimit të qumështit

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Ndërmarrjet që aplikojnë për çertifikim me HACCP dhe / ose ISO 22000, të cilat specifikojnë investimet e nevojshme për çertifikimin me këto standarde	30
	Ndërmarrjet që janë plotësisht të çertifikuara me HACCP dhe / ose ISO 22000	25
2.	Investime që mundësojnë diversifikimin e prodhimit me së paku dy produkte të reja	10
3.	Shitjet e aplikuesit gjatë vitit 2015 kanë qenë nga 200,000 € deri në 4,000,000 €, të dëshmuara me pasqyrat financiare, të dorëzuar në ATK	10
4.	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR në dy vitet e fundit	10
5.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për ≥ 2 - < 5 vjet = 5 pikë Për ≥ 5 vjet = 10 pikë	Max. 10
6.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i destinohen mbrojtjes së mjedisit: investime për menaxhimin e mbeturinave dhe trajtimin e ujit	10
7.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i destinohet prodhimit të energjisë së ripërtërishme	5
8.	Krijimi i vendeve të reja të punës: për çdo punëtor të ri të punësuar nga 1 pikë, por jo më shumë se 10 pikë në total	Max. 10
9.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit (të dëshmohet me pasqyrat financiare, të verifikuara nga ATK)	5
GJITHSEJ		100

Tabela 2: Nënmasa e përpunimit të mishit

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët	
1.	Ndërmarrjet që aplikojnë për çertifikim me HACCP dhe / ose ISO 22000, të cilat specifikojnë investimet e nevojshme për çertifikimin me këto standarde	30	
	Ndërmarrjet që janë plotësisht të çertifikuara me HACCP dhe / ose ISO 22000	25	
2.	Për thertoret	Futja e linjave të specializuara për therjen e ripër- typësve të vegjël (dele, dhi)	10
	Për përpunuesit e mishit	Investime që mundësojnë diversifikimin e prodhimit me së paku dy produkte të reja	10
3.	Së paku 30% e lëndës së parë (kafshë ose mish) të përdorur është nga prodhimi ven- dor. Kjo duhet të dëshmohet përmes kontratave: në rast të thertoreve, me fermerët, ndërsa në rast të përpunuesve të mishit, me thertoret	10	
4.	Aplikuesi nuk ka përfutur grante nga MBPZHR në dy vitet e fundit	10	
5.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i destinohen mbrojtjes së mjedisit: inves- time për menaxhimin e mbeturinave dhe trajtimin e ujit	10	
6.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i destinohet prodhimit të energjisë së ripërtërishme	5	
7.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për ≥ 2 - < 5 vjet = 5 pikë Për > 5 vjet = 10 pikë	Max. 10	
8.	Krijimi i vendeve të reja të punës: për çdo punëtor të ri të punësuar nga 1 pikë, por jo më shumë se 10 pikë në total	Max. 10	
9.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit (të dëshmohet me pasqyrat financiare, të verifikuara nga ATK)	5	
GJITHSEJ		100	

Tabela 3: Nënmasa e përpunimit të pemëve dhe të perimeve

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet për qendrat e deponimit ose qendrat për përpunim: ndërtimi i qendrave të reja apo rinovimi / zgjerimi i qendrave ekzistuese, duke përfshirë pajisje të ftohjes dhe të ngrirjes, pajisje për klasifikim / paketim / etiketim. Kujdes: Në rast të qendrave të deponimit, investimet janë të pranueshme vetëm në objekte me kapacitet së paku 1000m ³ . Pikët nga ky kriter do të llogariten me kusht që së paku 25% e investimit të përgjith- shëm i është dedikuar investimit për qendrat e deponimit.	35
2.	Investime që mundësojnë diversifikimin e prodhimit me së paku dy produkte të reja	10
3.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për ≥ 2 - < 5 vjet = 5 pikë Për ≥ 5 vjet = 10 pikë	Max. 10
4.	Së paku 80% e prodhimit të mbledhur është nga prodhimi vendor. Kjo duhet të dësh- mohet përmes kontratave me fermerët, duke përfshirë edhe listën e fermerëve si dhe sasinë e pranuar.	10

5.	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR-ja në dy vitet e fundit	10
6.	Së paku 5% nga investimet e pranueshme i destinohen mbrojtjes së mjedisit: investime për menaxhimin e mbeturinave dhe trajtimin e ujit	5
7.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i destinohet prodhimit të energjisë së ripërtërishme	5
8.	Krijimi i vendeve të reja të punës: për çdo punëtor të ri të punësuar nga 1 pikë, por jo më shumë se 10 pikë në total	Max. 10
9.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit (të dëshmohet me pasqyrat financiare, të verifikuara nga ATK)	5
GJITHSEJ		100

Tabela 4: Nënmasa e prodhimit të verës

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet në Linja të Prodhimit për verën në shishe, përfshirë për verën e shkumëzuar.	35
2.	Investimet në objekte dhe / apo pajisje të ruajtjes. Kujdes: Pikët nga ky kriter do të llogariten me kusht që së paku 25% e investimit të përgjithshëm i është dedikuar investimit sipas këtij kriteri.	20
3.	Së paku 80% e rrushit që përpunohet është nga prodhimi vendor. Kjo duhet të dëshmohet përmes sasisë së prodhuar nga vet aplikuesi dhe / apo kontratave me fermerët, duke përfshirë edhe listën e fermerëve si dhe sasinë e pranuar.	10
4.	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR në dy vitet e fundit	10
5.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për ≥ 2 - < 5 vjet = 5 pikë Për ≥ 5 vjet = 10 pikë	Max. 10
6.	Krijimi i vendeve të reja të punës: për çdo punëtor të ri të punësuar nga 1 pikë, por jo më shumë se 10 pikë në total	Max. 10
7.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit (të dëshmohet me pasqyrat financiare, të verifikuara nga ATK)	5
GJITHSEJ		100

VËREJTJE PËR TË GJITHA NËNMASAT:

Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

Projektet e Masës 103 duhet të realizohen brenda dy viteve buxhetore.

Afati i implementimit të projekteve të kësaj mase është 12 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas kësaj periudhe, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjasë afatin e implementimit për më së shumti 2 muaj, nëse ka arsye të forta për këtë, siç është sjellja e ndonjë prej ndonjë vendi të huaj, etj.

7. RREGULLAT PËR SHPENZIMET E PAPRANUESHME

Shpenzimet e papranueshme janë çështje e përfituesit dhe nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë. Përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre.

Për shpenzimet e papranueshme nuk është e nevojshme të respektohen procedurat e prokurimit.

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë shpenzime të pranueshme:

- ▶ Shpenzimet e krijuara para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, përveç shpenzimeve administrative;
- ▶ Tatimet, përfshirë TVSH-në;
- ▶ Taksat doganore dhe të importit ose ndalesat tjera;
- ▶ Blerja, marrja me qira e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
- ▶ Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e gjyqit;
- ▶ Shpenzimet operative;
- ▶ Pajisjet e dorës së dytë;
- ▶ Ndalesat bankare, shpenzimet e garantimit dhe ndalesat e ngjashme;
- ▶ Shpenzimet e konvertimit, ndalesat dhe humbjet nga ndërrimi i valutës;
- ▶ Kontributet në natyrë;
- ▶ Blerja e të drejtave për prodhimtari bujqësore, kafshëve, bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
- ▶ Çfarëdo shpenzimi për mirëmbajtje, zhvlerësim apo qira;
- ▶ Çfarëdo shpenzimi nga administrata publike në menaxhimin dhe zbatimin e asistencës;
- ▶ Shpenzimet lidhur me blerjen me lizing si marzha e dhënësit të lizingut, shpenzimet e rifinancimit të kamatës, shpenzimet e përgjithshme (overheads) dhe ato të sigurimit.

8. PROCEDURAT E APLIKIMIT

8.1. PËRMBAJTA E APLIKACIONIT

Kujdes: Një aplikacion konsiderohet i pranueshëm, nëse përmban të gjitha dokumentet e radhitura sipas listës së paraqitur në Shtojcën Nr. 1 të formularit të aplikimit.

Në rastet kur kërkohen kopje të dokumenteve, dokumentet në origjinal duhet t'u prezantohen zyrtareve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesi duhet ta shkruajë në kopje këtë tekst: "si në origjinal", dhe ta nënshkruajë.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në zyrat rajonale të AZHB-së në adresat dhe kontaktet e paraqitura në Shtojcën Nr. 10.

8.2. DORËZIMI I APLIKACIONEVE DHE AFATI I FUNDIT

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftimi publikohet në ueb faqen e internetit të MBPZHR-së: <http://www.mbpzhr-ks.net/> dhe në ueb faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Aplikacionet së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara si në Shtojcën Nr. 1, duhet të dorëzohen brenda periudhës së përcaktuar në shpallje.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin dhe e udhëzon aplikuesin për përmbushjen e dokumentave që i mungojnë. Aplikuesi ka afat t'i kompletojë dokumentet deri në përfundim të thirrjes për aplikim.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Zyrrat Rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në adresat dhe kontaktet e zyrtarëve të paraqitura në Shtojcën Nr. 10.

9. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI

VLERËSIMI I PLANIT TË BIZNESIT

Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme duhet të përmbajnë një Plan të Biznesit, sipas modelit të paraqitur në Shtojcën 2.

Plani i Biznesit është pjesë e verifikimit dhe kontrollit nëse dokumentet janë të kompletuara dhe të pranueshme. Megjithatë, disa informacione që përfshihen në këto dokumente duhet të merren parasysh për poentimin e aplikacioneve. Gjithashtu, këto dokumente duhet të paraqesin burimin e të dhënave të përdorura për plotësimin e formularit për indikator.

Të dhënat / informatat e paraqitura brenda këtyre dokumenteve duhet të kontrollohen në të gjitha bazat e të dhënave ekzistuese (Regjistrin Kadastral të Vreshtave, Listën e kategorizimit të objekteve për përpunimin e ushqimit sipas kategorisë A, B, C, D i ndërmarrjeve (AUV), duhet të mbështeten me dokumente shtesë – si në Shtojcën Nr. 1, dhe duhet të jenë subjekt kontrollimi në terren para se kontrata të nënshkruhet, para pagesës së mjeteve financiare dhe pasi që projekti është përfunduar, gjatë periudhës së monitorimeve ex-post.

Kujdes: Aplikacionet me të dhëna të pasakta ose të pavërteta refuzohen menjëherë. Nëse vërtetohet se përfituesit i është bërë ndonjë pagesë duke u bazuar në të dhëna të pasakta ose të pavërteta të parashtruara nga i njejt, përfituesi obligohet ta kthej shumën e pranuar. Çdo përpjekje për mashtrim duhet të raportohet dhe të trajtohet si mashtrim me fondet publike!

Plani i Biznesit duhet ta respektojë plotësisht modelin e përgatitur nga MBPZHR-ja. Këto nuk janë vetëm dokumente "për t'u plotësuar", por përfshijnë rekomandimet se si këto dokumente duhet të përgatiten. Të gjithë kapituljt duhet të trajtohen.

Mostrajtimi i ndonjë kapitulli është arsye e mjaftueshme për refuzim të aplikacionit. Paraqitja e kapituljeve shtesë nuk do të merret parasysh gjatë vlerësimit të projektit.

Pikat e mëposhtme janë pjesë e vlerësimit të Planit të Biznesit:

1. Të gjithë kapitujt dhe nënkaptujt janë trajtuar, nëse nuk është relevante për aplikuesin atëherë duhet sqaruar arsyeja;
2. Është përmbushur së paku 1 (një) objektive specifike e masës;
3. Projekti është në përputhje me potencialin e zonës;
4. Kthimi i investimeve dëshmon që fitimi shtesë (të hyra shtesë – kosto shtesë) mbulon kostot e investimeve (të llogaritet vetëm bashkëfinancimi privat) për më pak se 10 vjet;
5. Numër të mjaftueshëm të stafit (të punësuar) për të funksionuar biznesi;
6. Blerjet / ndërtimet e propozuara janë në bazë të nevojave të aplikuesit (psh. jo më shumë pajisje sesa ka nevojë, nuk lejohen ndërtimet nëse aplikuesi ka hapësira të mjaftueshme);
7. Blerjet / ndërtimet e propozuara janë në përputhje me procesin e aplikuar teknologjik;
8. Kostot për t'i vlerësuar blerjet/ndërtimet duhet të jenë të arsyeshme;
Aplikuesi duhet të kontrollojë nëse kosto e paraparë e investimit të tij është në përputhshmëri me çmimet e tregut të paraqitura në uebfaqen e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor (<http://azhb-ks.net>). Në rastet ekstreme kur aplikuesi prezanton kosto të parapara më të larta, atëherë Planit të Biznesit duhet t'i bashkëngjiten 3 propozime duke justifikuar kostot më të larta. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë duhet t'i shqyrtojë gjithashtu propozimet dhe në rast se nuk është në përputhje me çmimin e tregut, Plani i Biznesit duhet të refuzohet.
9. Orari për blerjet/ndërtimet është real dhe jep mundësinë që investimi të përfundojë në kohën optimale, ashtu siç është paraparë në përshkrimin e masës;
10. Duhet të prezantohet kapaciteti i prodhimit para dhe pas investimit;
11. Rritja e paraparë në kapacitetin prodhues është plotësisht e dëshmuar bazuar në investimin e propozuar;
12. Është përshkruar procesi teknologjik dhe teknologjia e zbatuar;
13. Procesi teknologjik është në përputhje me asetet ekzistuese si dhe investimet e parapara (të mundshme) të ofruesit të shërbimeve;
14. Furnizuesit potencial dhe klientët potencialë janë identifikuar (duke dëshmuar përmes kontratave dhe parakontratave);
15. Strategjia e tregut është reale;
16. Për të gjitha investimet e pranueshme dhe të papranueshme janë paraqitur saktë kushtet e nivelit të ndihmës publike dhe niveli i ndihmës private;
17. Për 2 vitet e fundit duhet të paraqitet nëse aplikuesi ka pasur fitim apo humbje, personat juridikë duhet ta dorëzojnë pasqyrën e të ardhurave dhe bilancin e gjendjes;
18. Për 5 vitet e ardhshme pasi që investimi është përfunduar, në fund të çdo muaji, bilanci i rrjedhjes së parasë duhet të jetë pozitiv;
19. Shpenzimet e parapara përfshijnë: kosto shtesë të mbështetura me fuqi punëtore shtesë (pagat dhe kontributet), energjinë e konsumuar shtesë, pagesat për furnizuesit e rinj, ofruesit e shërbimeve, kthimin e huas etj.;
20. Të gjitha kostot shtesë janë të njëjta gjersa e kalkulojmë kthimin e investimit;
21. Të hyrat e parapara shtesë janë në përputhje me kapacitetin prodhues;
22. Të hyrat e parapara shtesë janë në përputhje me strategjinë e marketingut (psh. është e pamundur që një sasi e madhe e perimeve të shpërndahet direkt nga përfituesi në tregun e gjelbër);
23. Të hyrat shtesë në llogaritjen e kthimit të investimit janë në përputhje me prodhimin shtesë të paraqitur në indikatorët e ndikimit.
24. Aplikuesi nuk ka krijuar kushte artificiale për të përfituar përparësi.

KONTROLLET NË TERREN

Janë të parapara së paku 3 kontrolle në terren:

- 1) para së të nënshkruhet kontrata,
- 2) pas çdo kërkesë për pagesë,
- 3) gjatë periudhës së monitorimit ex-post, deri 5 vite pas implementimit të projektit.

Kujdes: Kur kërkohet të kontrollohet, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëhershme në ndërmarrje, në pajisjet e ndërmarrjes dhe ndonjë dokument të kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodhë mosrespektimi i këtij kushti, duhet të bëhet kthimi i menjëhershëm i përkrahjes publike dhe do të aplikohet ndëshkimi i përfituesit!

RADHITJA NË LISTË

Të gjitha projektet që kanë kaluar kriteret e pranueshmërisë, pas vlerësimit, duhet të radhiten në bazë të pikëve të fituara dhe do të përfitojnë përkrahjen me mjetet financiare publike, duke filluar prej aplikacioneve me më shumë pike.

PROCEDURAT E PËRKRAHJES ME FONDET PUBLIKE DHE NJOFTIMI I APLIKUESIT

Pas vlerësimit, AZHB përgatit raportin e vlerësimit. Projektet klasifikohen në këtë raport në:

- 1) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë) dhe
- 2) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë.

Ky raport nënshkruhet nga Kryeshefi i AZHB.

Pas vlerësimit, AZHB përgatit Raportin e Vlerësimit. Projektet klasifikohen në këtë raport në: 1) projekte të papranueshme dhe të vlerësuara me pikë dhe 2) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë). Raporti preliminar, nënshkruhet nga kryeshefishefi i AZHB-së dhe publikohet në ueb faqe të Azhb-së dhe ueb faqe të MBPZHR .Të pakënaqurit, 15 ditë nga dita e publikimit të Raportit preliminar mund të paraqiten në AZHB dhe të informohen për detajet e vlerësimit dhe të marrin letrën informuese me sqarimet rreth vlerësimit ose vendimit.

Prej ditës së pranimit të Letrës Informuese, aplikuesi ka afat 15 ditë të ushtrojë ankesë, në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Ankesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e letrës informuese dhe nëse ka edhe ndonjë dokument tjetër.

Pas marrjes së vendimit për refuzim aplikuesi ka të drejtë ankesë në komisionin e ankesave. Komisioni i Ankesave merr vendim brenda 30 ditësh.

ORARI INDIKATIV I SHPALLJES

AZHB shpallë thirrjet për aplikim në çerekun e parë të vitit 2016. Ftohen të interesuarit që të vizitojnë ueb-faqen e AZHB-së: <http://azhb-ks.net> së paku një herë në javë.

KONTRATA MES PËRFITUESIT DHE AZHB-SË, SI DHE PROCEDURAT E PROKURIMIT

Të gjithë përfituesit do të nënshkruajnë një kontratë standard, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën Nr.3. Plani i Biznesit, së bashku me të gjitha dokumentet e paraqitura bëhet pjesë e kontratës. Kontrata mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri në përfundim të periudhës monitoruese, që është 5 vjet pas implementimit të projektit.

PAGESA E MJETEVE PUBLIKE PËR PROJEKTET E ZHVILLIMIT RURAL

Pas nënshkrimit të Kontratës, përfituesi mund të paraqesë kërkesën për paradhënie deri në 50% të ndihmës publike, duke plotësuar formularin e ofruar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, si në Shtojcën Nr. 6.

Ndërkaq, pjesa e mbetur e investimeve publike do të realizohet deri në kërkesën e aplikuesit pasi të të ketë përfunduar i tërë investimi.

Kërkesës për Pagesë përfundimtare, përfituesi duhet t'ia bashkëngjese dëshmitë e pagesës (faturat dhe kuponin fiskal ose transferin bankar për pagesat nën vlerën 500 euro, kurse për pagesat me vlerë 500 e më shumë euro faturat dhe transferin bankar) si dhe provat e kryerjes së procedurave të prokurimit, nëse një gjë e tillë është e paraparë me kontratë. Aprovimi i pagesës do të realizohet pas kontrollimit të dokumenteve dhe pas kontrollit në terren të kryer nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Kujdes: Llogaria në të cilën do të kryhet pagesa nga AZHB duhet të jetë e personit juridik dhe JO në emër të pronarit.

MONITORIMI EX-POST

Të gjitha projektet do të monitorohen për 5 vjet pas implementimit të projektit.

DISPOZITAT E RËNDËSISHME QË MUND TË JENË SHKAKTAR I REFUZIMIT TË APLIKACIONIT**Aplikacionet mund të refuzohen nëse:**

- 1) nuk janë të kompletuara,
- 2) nuk e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë
- 3) për shkak të numrit të vogël të pikëve (pragu minimal i pikeve në këto mase duhet të jetë 50 pike).

Kujdes: Arsytet e refuzimit duhet të paraqiten dhe sqarohen në Letrën informuese të cilën AZHB ia dërgon aplikuesit.

Aplikacionet e pakompletuara refuzohen në momentin e verifikimit nga zyrtari i AZHB me rastin e dorëzimit të tyre. Në rast se konstatohet më vonë se aplikacioni nuk është i kompletuar, ai po ashtu refuzohet.

Aplikacionet e papranueshme – deklarohen të papranueshme gjatë procesit të vlerësimit të cilin e bëjnë zyrtarët e AZHB. Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë

kontrollit administrativ (psh. mospërputhje me të dhënat nga Regjistri i Fermës), gjatë vlerësimit të dokumenteve (psh. vlerësimi i Planit të Biznesit) ose gjatë kontrollit në terren. Projektet e papranueshme nuk i nënshtrohen procesit të dhënies së pikëve (selektimit).

Kujdes: Për aplikacionet e pakompletuara, aplikuesi njoftohet menjëherë. Aplikacionet e papranueshme dhe ato të pranueshme, por me numër të vogël të pikëve, janë pjesë e Raportit të Vlerësimit.

10. LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA NR. 1	FORMULARI I APLIKIMIT PËR MASËN 103
SHTOJCA NR. 2	MODELI PËR PËRGATITJEN E PLANIT TË BIZNESIT
SHTOJCA NR. 3	KONTRATA E AZHB-SË ME PËRFITUES DHE PROCEDURAT E PROKURIMIT
SHTOJCA NR. 4	LISTA E SHPENZIMEVE TË PRANUESHME
SHTOJCA NR. 5	STANDARDET MINIMALE KOMBËTARE
SHTOJCA NR. 6	KËRKESA PËR PAGESË
SHTOJCA NR. 7	LETRA INFORMUESE
SHTOJCA NR. 8	FORMA E ANKESËS PËR AGROPËRPUNUES
SHTOJCA NR. 9	ZYRAT RAJONALE TË AGJENCISË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË
SHTOJCA NR. 10	DREJTORITË KOMUNALE TË BUJQËSISË
SHTOJCA NR. 11	INDIKATORËT E NDIKIMIT, PJESA FINANCIARE E PLANIT TË BIZNESIT (NË EXCEL)
SHTOJCA NR. 12	PJESA FINANCIARE E PLANIT TË BIZNESIT (NË EXCEL)
SHTOJCA NR. 13	KODI I ETIKËS PËR KOMPANITË KËSHILLUESE
SHTOJCA NR. 14	PROMOVIMI
SHTOJCA NR. 15	LISTA KONTROLLUESE PËR PËRZGJEDHJE MJEDISORE

SHTOJCA NR. 1
FORMULARI PËR APLIKIM



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

FORMULARI PËR APLIKIM MASA 103, NËNMASA: 103...	
I. Emri i Aplikuesit	<p>-----</p> <p>-----</p> <p>-----</p> <p>(Emri i subjektit juridik)</p>
	Numri personal
	Komuna:
	Vendbanimi:
	Adresa:
	Telefoni:
	E - mail:
	Ueb faqja:
II. Emri i Projektit	<p>-----</p> <p>-----</p> <p>-----</p>

Vetëm për përdorim zyrtar (të plotësohet nga zyrtari rajonal):	
Numri unik regjistruar i projektit (NUR):	
III. Data	{ / / }
IV. Koha:	(ora dhe minuta, të plotësohet vetëm kur aplikacioni të jetë kompletuar)
V. Aplikacioni është kompletuar	PO JO

Nënshkrimi i aplikuesit _____

VI. Numri Identifikues i Fermës (NIF):																					
VII. Numri i Regjistrimit të Biznesit:																					
VIII. Për të gjithë aplikuesit:																					
Banka	Emri i bankës:																				
	IBAN:																				
	Nr. llogarisë rrjedhëse:																				
	Adresa:																				
Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri i cili dorëzohet në origjinal, dhe të autorizuarit i merren të dhënat e mëposhtme																					
Emri		Numri Personal																			
Emri i Babës		E - mail:		_____																	
Mbiemri		_____																			
IX. Deklaratat																					

<ul style="list-style-type: none"> ▶ Unë jam një mikrondërmarrje / ndërmarrje e vogël apo e mesme (NVM), që i përgjigjet kushteve të mëposhtme: ▶ Unë kam të punësuar më pak se 250 persona; ▶ Unë kam një xhiro vjetore që nuk kalon 50 milion euro dhe / ose një bilanc vjetor që nuk i kalon 43 milionë euro. 			
Unë kam të paktën 2 vite eksperiencë në sektorin përkatës siç dëshmon dokumenti nr. 4 (në Shtojcën e këtij formulari) - Certifikata e Regjistrimit të Biznesit.			
<p>Në rastin e aplikuesve në sektorin e përpunimit të qumështit dhe mishit: Unë jam i regjistruar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, siç dëshmohet nga dokumenti i bashkangjitur, dhe unë jam në kategori A, B, C ose D (ky dokument shkarkohet nga uebfaqja e AUV-së). Ndermarrja në kategorinë "C" do të aplikoj për ndertim të ri me kusht të mbylljes së objektit ekzistues ose rinovim të objektit ekzistues. Ndermarrja në kategorinë "D" do të aplikoj për ndertim të ri dhe puntoria e kuzistuese do të mbyllet.</p>			
<p>Në rastin e aplikuesve për sektorin e prodhimit të verës: Unë deklaroj se gjatë vitit 2015 i kam prodhuar litra verë, siç dëshmohet me dokumentin e lëshuar nga Departamenti i Verave dhe Vreshtave, Nr. 9, i bashkangjitur.</p>			
Deklaratat e mëposhtme janë për qëllime të poentimit të aplikacionit (aplikuesi duhet të shënojë PO ose JO)			
Të paktën 80% e lëndës së parë për përpunim të verës, pemëve, perimeve ose 30% e lëndës së parë (kafshë ose mish) në rastin e thertoreve dhe mishit, është nga prodhimi vendor, që vërtetohet me Listat e Kontratave, dokumenti Nr. 16 i bashkangjitur dhe siç është paraqitur në Planin e Biznesit.	Po	Jo	
Plani i biznesit përfshinë investimet në pastrimin dhe trajtimin e mbeturinave / trajtimin e ujit, dhe janë së paku 10% nga investimet e përgjithshme të pranueshme.	Po	Jo	
Ndërmarrja ka pasur afarizëm pozitiv brenda 2 viteve të fundit, që dëshmohet me pasqyrat e të ardhurave nga ATK, sipas dokumentit Nr. 12 të listës së dokumentave të dorëzuara.	Po	Jo	
Plani i Biznesit përfshinë vendet e reja të punës të krijuara siç është prezantuar në Planin e Biznesit dhe në Listën e stafit të Kompanisë, në momentin kur dorëzohet Formulari për Aplikim dhe vërtetohet nga dokumenti Nr. 13 – i bashkangjitur.	Po	Jo	
Për sektorin e qumështit, unë deklaroj se:	Investimet e propozuara do të shprijnë në certifikimin HACCP, që vërtetohet nga dokumenti Nr. 20 – i bashkangjitur.	Po	Jo
	Plani i Biznesit përfshinë investimet në diversifikimin e aktiviteteve, duke shtuar të paktën 2 produkte të reja – siç vërtetohet nga dokumenti Nr. 22 - Libri i shitjeve nga viti i kaluar, i bashkangjitur.	Po	Jo
	Pasqyra e të ardhurave për vitin paraprak, e vulosur nga ATK dëshmon se aplikuesi ka pasur të hyra më shumë se 200 000 euro dhe më pak se 4 milionë euro, dokumenti Nr. 12 – i bashkangjitur.	Po	Jo
Për sektorin e thertoreve dhe përpunimit të mishit, unë deklaroj se:	Investimet e propozuara do të ndikojnë në certifikimin HACCP, që vërtetohet nga dokumenti Nr. 21 – i bashkangjitur.	Po	Jo
	Për thertoret (nëse së paku 50% të investimeve të pranueshme janë për thertore): Plani i Biznesit përfshinë futjen e linjave të specializuara për therjen e ripërtpësve të vegjël.	Po	Jo
	Përpunuesit e tjerë të mishit (nëse së paku 50% e investimeve të pranueshme janë për përpunim të mishit): Plani i Biznesit përfshinë investime që shprijnë në diversifikimin e prodhimit për së paku dy produkte të reja. Produktet e reja të parapara nuk janë në librin e shitjeve të vitit të kaluar - dhe vërtetohet nga libri i shitjeve, dokumenti Nr. 23 – i bashkangjitur.	Po	Jo

Për sektorin e pemëve dhe perimeve, unë deklaroj se:	Investimet për qendrat e deponimit ose qendrat për përpunim: ndërtimi i qendrave të reja apo rinovimi / zgjerimi i qendrave ekzistuese, duke përfshirë pajisje të ftohjes dhe të ngrirjes, pajisje për klasifikim / paketim / etiketim.	Po	Jo
	Kujdes: Në rast të qendrave të deponimit, investimet janë të pranueshme vetëm në objekte me kapacitet së paku 1000m ³ . Pikët nga ky kriter do të llogariten me kusht që së paku 25% e investimit të përgjithshëm i është dedikuar investimit për qendrat e deponimit.		
Për sektorin e verës, unë deklaroj se:	Plani i biznesit përfshinë investimet për futjen e linjave për përpunim të produkteve të reja në nivelin e ndërmarrjeve - siç vërtetohet nga dokumenti Nr. 23 - libri i shitjeve nga viti i kaluar – i bashkangjitur.	Po	Jo
	Plani i biznesit përfshinë investime në linjat e prodhimit për verë në shishe, përfshirë për verën e shkumëzuar.	Po	Jo
Për sektorin e verës, unë deklaroj se:	Plani i biznesit përfshinë se paku 25% të mbështetjes publike për investime në depo ose pajisje për ruajtjen e verës.	Po	Jo
Nënshkrimi i aplikuesit _____			
X. Zotimet			
Unë zotohem se do të sigurojë shpenzimet e bashkëfinancimit dhe ato të papranueshme të projektit.			
Para se të dorëzojnë kërkesën për pagesën e fundit në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, e gjithë ndërmarrja do të jetë në përputhje me standardet përkatëse minimale kombëtare në fuqi.			
Investimet e përfshira në kuadër të Planit të Biznesit janë në përputhje me standardet minimale kombëtare.			
Unë zotohem se do të vazhdoj aktivitetet e ndërmarrjes dhe do të ruajë qëllimin e investimeve të mbështetura për të paktën 5 vite pas implementimit të projektit.			
Unë zotohem për krijimin e _____ vendeve të reja të punës si rezultat i zbatimit të projektit, ashtu siç është prezantuar në planin e biznesit.			
Të gjitha të dhënat, informatat dhe dokumentacioni, të cilin unë e kam paraqitur në këtë formular për aplikim janë të vërteta. Jam i vetëdijshëm se paraqitja e të dhënave të pavërteta			

XI. KALKULIMI DHE PËRQINDJA E PËRKRAHJES

Përkrahja me mjete publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme.

A janë paraparë investime për trajtimin e mbetjeve?

Po Jo

Nëse PO, vetëm për investimin në trajtimin e mbetjeve, përkrahja është 60%.

XII.TABELA FINANCIARE E PROJEKTIT - SIÇ PARAQITET NË PLANIN E BIZNESIT

	Investimet e pranueshme (pa TVSH)	Përqindja e përkrahjes	Ndihma publike, pa TVSH (€)	Financimi nga ana e përfituesit (pa TVSH)
Totali i shpenzimeve të pranueshme – përveç shpenzimeve për trajtimin e mbetjeve		50%		
Shpenzimet për trajtimin e mbetjeve (nëse ka)		10%		
Totali				

(Emri, mbiemri
dhe
nënshkrimi i aplikuesit)

(Emri, mbiemri
dhe
nënshkrimi i zyrtarit rajonal)

Datë: _____

LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

Aplikacioni duhet t'i ketë dokumentet e radhitura si në listën e mëposhtme dhe çdo faqe duhet të ketë të shkruar numrin (me dorë). Ky numër duhet të paraqitet në listë pranë emrit të dokumentit.

Dosja e aplikacionit dorëzohet në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e dosjes fizike skanohen dhe ruhen në një CD e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike. Këshillohen aplikuesit që një kopje të dosjes ta ruajnë për nevoja të veta.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikuesin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce duke ia shenjuar dokumentet që i mungojnë aplikuesit. Aplikuesi ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që t'i kompletojë dokumentet.

Në rastet kur kërkohet vetëm kopje e dokumentit, aplikuesi e shkruan me dorë në kopje "sikur në origjinal" dhe ia sjell origjinalin në shikim zyrtarit rajonal i cili verifikon përputhshmërinë e kopjes dhe ia kthen origjinalin aplikuesit.

Nr.	Dokumenti	Obligativ	opcional
1.	FORMULARI PËR APLIKIM Sipas modelit të AZHB-së i plotësuar me kompjuter (nuk lejohet dorëshkrimi). (Kontrollohet nga zyrtari, nëse dokumentet janë të plotësuar si duhet në momentin e dorëzimit në prani të aplikuesit).	F. __ <input type="checkbox"/>	
2.	LLOGARIA RRJEDHËSE, dokument i lëshuar dhe vulosur nga banka (në origjinal). Llogaria rrjedhëse duhet të jetë nga një bankë që operon në Kosovë.	F. __ <input type="checkbox"/>	
3.	CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN E FERMËS - Kopje	F. __ <input type="checkbox"/>	
4.	CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT - Kopje	F. __ <input type="checkbox"/>	
5.	CERTIFIKATA E NUMRIT FISKAL - Kopje	F. __ <input type="checkbox"/>	
6.	PLANI I BIZNESIT	F. __ <input type="checkbox"/>	
7.	Nga Agjencia Ushqimit dhe Veterinës - kopje: Vendim për aprovim - në rastin e përpunimit të qumështit dhe mishit Vendim për Regjistrim - në rastin e sektorit të pemëve, perimeve dhe verës	F. __	
8.	Aplikuesit për prodhim të verës: Certifikata e Vreshtarit nga Regjistri Kadastral i Vreshtave – në rast se ka vreshta – kopje	F. __	
9.	Aplikuesit për prodhim të verës: Dokumenti nga DVV për prodhimin vjetor - në origjinal	F. __	
10.	Certifikata nga regjistri i prodhuesve të verës në Kosovë – kopje	F. __	
11.	VËRTETIM nga Administrata Tatimore e Kosovës që dëshmon se aplikuesi nuk ka obligime të papaguara tatimore- në origjinal	F. __ <input type="checkbox"/>	
12.	Pasqyra e të ardhurave, e vulosur nga ATK - për dy vitet e fundit –kopje.	F. __ <input type="checkbox"/>	
13.	Lista e stafit të kompanisë në momentin kur dorëzohet formulari për aplikim - në origjinal	F. __ <input type="checkbox"/>	
14.	AUTORIZIMI - Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri - në origjinal	F. __ <input type="checkbox"/>	

15.	KONTRATA E PUNËS së përfaqësuesit të ndërmarrjes me kohëzgjatje së paku për 5 vjet – kopje	F.____ <input type="checkbox"/>	
16.	LISTA E KONTRATAVE me fermerë dhe kopjet e kontratave – nëse aplikuesi i posedon ato	F.____ <input type="checkbox"/>	
17.	Në rast të investimeve në ndërtim / zgjerim, aplikuesi duhet të paraqes: ▶ Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi; ▶ Fletën poseduese për parcelën ku do të bëhet investimi	F.____ <input type="checkbox"/>	
18.	Në rastin e investimeve të ndërtimit / zgjerimit, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë: Kopjet e skicave të objektit dhe një parallogaritje e shpenzimeve të materialit dhe punëve të parapara	F.____ <input type="checkbox"/>	
19.	Pëlqim nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit / zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit	F.____ <input type="checkbox"/>	
20.	Bizneset joraportuese të TVSH-së: dokumenti i shtypur nga uebfaqja e ATK-së: http://apps.atkks.org/BizPasiveApp/VatRegist/SearchVat	F.____ <input type="checkbox"/>	
21.	Raporti / Paravlerësimi pozitiv për implementimin e standardeve të sigurisë HACCP ose ISO 22 000, me specifikim të investimeve të nevojshme për certifikim me këto standard, i përgatitur në bazë të kërkesës standarde, nga teknologu i ndërmarrjes apo eksperti i jashtëm		F.____ <input type="checkbox"/>
22.	Certifikata për HACCP/ISO 22000 – kopje, nëse aplikuesi është i certifikuar	F.____ <input type="checkbox"/>	
23.	Libri i shitjeve nga viti i kaluar – kopje	F.____ <input type="checkbox"/>	
24.	FORMULARI PËR INDIKATOR i plotësuar në prani të aplikuesit, zyrtari verifikon a është plotësuar si duhet formulari për indikatorët	F.____ <input type="checkbox"/>	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

MODEL PËR PËRGATITJEN E PLANIT TË BIZNESIT

për projektet e përkrahura nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

SHËNIM!

Ky dokument është një model si të shkruhet plani i biznesit dhe duhet të respektohet në tërësi. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet të njoftoni më një fjali brenda kapitullit përkatës.

PLANI I BIZNESIT DUHET TË DORËZOHET NË KOPJE FIZIKE.

Pjesa financiare e planit të biznesit duhet të bëhet në Excel, ashtu që vlerësimi të jetë më i lehtë dhe më i shpejtë.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

- 1.1. Emri i aplikuesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit)
- 1.2. Asetet kryesore në pronësi të aplikuesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë), objekte, pajisje dhe makineri, kafshë etj. – sikur në Regjistrin e Fermës.

Tabela 1. Asetet e aplikuesit

Asetet	Data e blerjes / ndërtimit	Gjendja e fundit e bilancit	Sasia (me copë)
1. OBJEKTET – GJITHSEJ			
1.1 detaje.....			
1.2 detaje.....			
2. PAJISJE – GJITHSEJ			
2.1 detaje.....			
2.2 detaje.....			
3. KAFSHË			
3.1 detaje.....			
3.2 detaje.....			
4. TË TJERA - DETAJE			
GJITHSEJ			

Tabela 2. Toka

Nr.	Rajoni/Komuna/Fshati	Sipërfaqja (m ²) / lloji i shfrytëzimit	Statusi juridik
1			
n			

2. PËRSHKRIMI PROJEKTIT

- 2.1. Emërtimi i investimit.
- 2.2. Vendi i projektit (rajoni, komuna dhe fshati).
- 2.3. Qëllimi, me përshkrimin e objektivave, arsytimit të nevojës dhe mundësisë së investimit.
- 2.4. Duhet të ceket konsistenca mes objektivave të Masës dhe objektivave të projektit. Sqarimet për objektivat e përgjithshme dhe së paku për një të një prej objektivave të projektit duhet të bëhet prezantimi sipas tabelës në vijim:

Tabela 3. Harmonizimi i objektivave të programit me ato të projektit

Objektivat e përgjithshme dhe specifike	Objektivat e projektit	Përshkrimi si do të arrihen objektivat
Për të rritur aftësinë konkurruese të pikave dhe qendrave grumbulluese për frutat pyjore, nëpërmjet shfrytëzimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore dhe përdorimit më të mirë të faktorëve të prodhimit, duke u fokusuar në vlerën e shtuar të prodhimit. (domosdoshme)		
Së paku një prej objektivave specifike në vijim:		
Objektiva specifike të masës dhe nënmasës		
Objektiva specifike të masës dhe nënmasës		

Tabela 4. Informata teknike dhe financiare

	Objektivat e projektit	Përshkrimi se si projekti synon t'i arrije objektivat
Projekti është në linjë me potencialin e zonës (obligative)	o	
Objektivat teknike (së paku një prej të poshtë shënuarave janë të obligueshme): Shpërndarja e mjeteve dhe pajisjeve që mund të ndikojnë në rritjen e prodhimit të punës, përmirësimin e kualitetit të produkteve bujqësore, njoftimit me përdorimin e teknologjive të reja dhe përmirësimin e kushteve të punës; Ndërtimi dhe modernizimi i objekteve vepruese të cilat sigurojnë standarde më të mira; Llojlojshmëria në prodhime sipas kërkesave të tregut, arrijtje në prodhimtari dhe njoftimi me teknologjitë e reja.	o o	
Indikatori financiar (obligativ): Kthimi i investimeve është koha e domosdoshme për fitimin neto extra (**ekstra vlera nga shitja-ekstra shpenzimet operacionale të lidhura me investimin) që të mbulojë shpenzimin e investimit). Duhet të jetë së paku 3 vjet për frutat e malit dhe 10 vjet për nën-masat e tjera të Masës 101 dhe Masën 103.	o	

<p>***Duhet të bëhet një prezantim ku theksohet saktësisht se për sa kohë duhet të përfundojë kthimi i investimit. Kthimi i investimit duhet të kalkullohet vetëm për pjesën e investimit që mbulohet me bashkëfinancim privat (shiko tab. 10).</p>	0	
<p>Duhet të merren parasysh vetëm investimet që në mënyre direkte gjenerojnë ekstra vlerë të prodhimit (si psh. traktor, apo ndonjë mjet për mjelje por jo stallë apo depo e plehut etj.);</p>	0	
<p>**Në rast të pemishteve të reja, vreshtave të rrushit ose pemëve të buta ekstra vlera e shitjes duhet të llogaritet për atë vit që bimët do të gjenerojnë rendimente maksimale;</p>	0	
<p>*** prezantimi duhet të mbështetet në të ardhurat dhe shpenzimet dhe të paraqiten në tabelën 11.</p>	0	

3. TË DHËNALIDHUR ME FUQINË PUNËTORE DHE MENAXHIMIN E PROJEKTIT

3.1. Menaxheri (emir, mbiemri, pozita Brenda organizatës, studimet relevante dhe përvoja profesionale _____

Numri i përgjithshëm i punonjësve aktual _____, prej të cilëve _____ me detyra ekzekutive.

3.2. Vlerësimet rreth fuqisë punëtore që do të punësohen pas zbatimit të projektit _____
_____ prej të cilave _____ vende të reja pune për zbatimin e projektit.

4. PËRSHKRIMI I BLERJEVE TË KRYERA PËRMES PROJEKTIT

Emri, numri, vlera, karakteristikat teknike dhe funksionale të makinerisë / pajisjeve / teknologjive / mjeteve të transportit / pajisjeve që do të blihen përmes projektit dhe , nëse është e nevojshme, prezantimi teknik i objekteve ku do të vendosen pajisjet dhe mjetet. Prokurimet duhet të bazohen në kapacitetet aktuale parashikuara të prodhimit.

Tabela 5. Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Nr.	Emri / lloji i pajisjeve / makinerisë	Njësitë	Vlera pa TVSh	TVSH	Gjithsej vlera me TVSh	Përqindja e përkrahjes publike
GJITHSEJ						

SHËNIM!

Nuk duhet të ceken emrat e prodhuesve, markat tregtare, emrat e ofertuesve etj.

5. KALENDARI I ZBATIMIT (MUAJT) DHE FAZAT KRYESORE

Orari i investimit i shprehur me vlera, muaj dhe aktivitete.

Tabela 6. Shembull / Orari për shpërndarje

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti (p.sh. 2016)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Psh. tavolina për pastrim	5 000		
Psh. makineria për klasifikim		15 000	
Psh. makineria për tharje			8 000

Tabela 7. Shembull/Orari për ndërtimin e objekteve të reja

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti (psh. 2016)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Psh. përbërësit e ndërtimit	5 000		
Psh. Ndërtimi i katit të 1-rë pa dritare dhe kulm		10 000	
Psh. kati i 1-rë, dritaret dhe kulmi			5 000

6. KAPACITETI PRODHUES

Kapacitetet prodhuese që rezultojnë nga investimi (në njësi fizike). Duhet të sillen specifikat lidhur me kapacitetin ekzistues para dhe pas finalizimit të investimit. Duhet të paraqitet përshkrimi i rrjedhës teknologjike të punës që aplikohet në teknologjinë e projektit.

7. FURNIZIMI I TREGUT / SHITJA

Tabela 8. *Furnizuesit potencialë të aplikuesit*

Furnizuesit potencialë të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndët e para / materialet ndihmëse / produktet / shërbimet	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma e përafërt	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1				
2				
N				

Tabela 9. *Klientët potencialë të aplikuesit*

Klientët potencialë të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa)	Vlera	% e shitjes
1			
2			
3			

8. KONKURRENCA DHE STRATEGJIA E TREGUT QË DUHET TË APLIKOHET

Përshkrimi i konkurrencës lokale dhe ndërkombëtare. Përshkrimi i strategjisë së tregut.

9. DETAJE FINANCIARE TË INVESTIMIT

Tabela 10. Shpenzime të detajuara të pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzimet e pranueshme	Ndihma publike	Bashkëfinancimi privat(euro)	Totali
Investimet e pranueshme			
...			
Shpenzimet administrative (psh. hartimi i planit të biznesit)			
Investimet e papranueshme			
TOTALI			

10. RRJEDHJA E PARASË SË GATSHME (TË ARDHURAT / PAGESAT)

Parashikimi i të ardhurave dhe pagesave për 3 vjet pas finalizimit të investimit. Aplikuesi duhet të demonstrojë profitabilitetin e fermës së tij për çdo vit si dhe disponueshmërinë mujore të parave të gatshme. Shuma e parave të marrë nga kredia regjistrohet si e hyrë kurse këstet mujore për kthimin e kredisë regjistrohen si shpenzim.

Në rastin e personave juridikë llogaritet pasqyra e të ardhurave për tri vitet e fundit që është dorëzuar në Administratën Tatimore.

Tabela 11. Rrjedhja e parasë dhe kthimi i investimit (shfrytëzoheni tabelën në excel)

	Të hyrat		Shpenzimet		Para të gatshme në dispozicion (euro)
	Artikulli	Vlera (euro)	Artikulli	Vlera (euro)	
Të hollat fillestare 2016, Muajt					
Janar					Të hollat fillestare + Të ardhurat - Shpenzimet = Duhet të jenë pozitive
Shkurt				
.....				

SHËNIM!

Supozimet duhet të shpalosen duke pasur parasysh gjendjen financiare të vitit të kaluar për projektin e dorëzuar. Për më tepër duhet të merren parasysh lidhja midis shitjes, parashikimit, përdorimit të kapacitetit të prodhimit dhe para kontratave të shitjes.

Po ashtu, duhet të detajohen të ardhurat prej aktivitetit më shumë sesa prej referimit të projektit.

SHTOJCA 3

KONTRATA E AZHB-SË ME PËRFITUES DHE PROCEDURAT E PROKURIMIT

Masa / Nënmasa _____

Kontrata për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural

Nr _____

Në mes të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), adresa _____,
përfaqësuar nga _____, Kryeshef i AZHB-së, në njërin anë,

Dhe

Zt. / Znj _____, me numër personal _____, Numri Identifikues i Fer-
mës (NIF) _____, si përfaqësues i personit juridik _____, me
numër fiskal _____, adresa _____, nr kontaktues _____,
si përfitues në anën tjetër, më tutje Palët, pajtohen të nënshkruajnë kontratën sipas formularit
për aplikim, bazuar në kushtet e mëposhtme:

NENI 1**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

- 1.1. Kjo kontratë krijon kornizë juridike dhe operacionale për AZHB-në për financimin e projektit të përfituesit;
- 1.2. Përfituesi do të financohet sipas kushteve të parapara në kontratë, për të cilat përfituesi deklaron se është i njoftuar dhe i pranor;
- 1.3. Pjesë obligative të kontratës janë:
 - a. Formulari i aplikimit dhe shtojcat e saj,
 - b. Projekti (plani i biznesit) dhe shtojcat e projektit të paraqitura nga përfituesi, pas vlerësimit.
- 1.4. Përfituesi pranor ndihmën publike dhe do të angazhohet për zbatimin e projektit në përgjegjësinë e vet duke respektuar dispozitat e kësaj kontrate dhe legjislacionin kombëtar në fuqi.
- 1.5. Përfituesi është i obliguar t'i respektojë tërësisht kushtet e kontratës gjatë implementimit të projektit (derisa të bëhet pagesa e fundit) dhe 5 vjet pasi që të bëhet pagesa e fundit, gjatë periudhës së monitorimit.

NENI 2

IMPLEMENTIMI DHE VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

- 2.1. Implementimi i kontratës fillon prej ditës që kontrata është nënshkruar nga të dyja palët.
- 2.2. Vlefshmëria e kontratës përfshinë periudhën kohore prej momentit të nënshkrimit të kontratës deri tek ekzekutimi i pagesës së fundit dhe 5 vjet të periudhës monitoruese, e cila llogaritet nga data e ekzekutimit të pagesës së fundit.

NENI 3

VLERA E KONTRATËS

- 3.1. Vlera totale e përkrahjes publike të projektit të financuar është <në nr> dhe (<në shkronja>).
- 3.2. 3.2 Vlera totale e pranueshme e projektit është <në nr> dhe (<në shkronja>).
- 3.3. 3.3 Vlera totale e projektit (përkrahja publike + bashkëfinancimi privat + shpenzimet e papranueshme) është <në nr> dhe (<në shkronja>).

NENI 4

PAGESA

- 4.1. PAGESA për Masën 103 bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në shumë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin dhe pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet me të përfunduar të investimit të përgjithshëm.
- 4.2. Shpenzimet e pranueshme administrative (që kanë lidhje me përpunimin teknik të projektit, planin e biznesit, inxhinieret, arkitektet etj.), mund të kërkojnë si rimbursim në përputhje me përqindjen e kështit.
- 4.3. PAGESA duhet të ekzekutohet duke u bazuar në kërkesën e pagesës së paraqitur nga përfituesi tek AZHB. Autorizimet e pagesës do të bëhen në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga përfituesi dhe rezultatet e kontrollit sipas udhëzimeve administrative të AZHB-së. Çdo autorizim i pagesës mund të bëhet i pavlefshëm në rast të ndonjë parregullsie të vërejtur, gjatë validitetit të kontratës.

NENI 5

KONTROLLIMI DHE MONITORIMI I PROJEKTIT GJATË VALIDITETIT TË KONTRATËS

- 5.1. Përfituesi është i obliguar t'i japë qasje të plotë çfarëdo kontrole të bërë nga AZHB-ja që ka lidhje me investimin e bërë, duke përfshirë të dhënat mbi punëtorët, kontabilitetin dhe taksat e paguara.
- 5.2. Në qoftë se AZHB vëren se investimi publik i financuar nuk është përdorur sipas qëllimit të tyre, planit teknik të projektit dhe planit të biznesit, ose është shitur ose dhënë me qira, AZHB ka të drejtë dhe obligim që të kërkojë kthimin e shpenzimeve të bëra.
- 5.3. Përfituesi është përgjegjës që ta ruajë qëndrueshmërinë ekonomike të investimit dhe të demonstrojë dobishmërinë e tij publike.

NENI 6

PLOTËSIME TË KONTRATËS

- 6.1. Përfituesi mund të kërkojë që të bëhen modifikime në kontratë vetëm në qoftë se ato nuk ndryshojnë pranueshmërinë dhe rezultatin e projektit dhe vetëm gjatë periudhës implementuese. Sidoqoftë këto modifikime nuk mund të kenë efekt retroaktiv. Modifikimet mund të ndikojnë në aspektin financiar dhe teknik vetëm nëse janë në përputhshmëri me masën, nëse nuk ndryshojnë qëllimin kryesor të projektit dhe nëse janë të limituara në maksimum 10% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.
- 6.2. Mbështetja totale publike që është aprovuar fillimisht nuk mund të rritet në asnjë rrethanë.
- 6.3. AZHB mund të miratojë ndryshime /plotësime të Kontratës sipas kërkesës së përfituesit, duke u bërë ato pjesë të kontratës.
- 6.4. Të drejtat dhe obligimet e kontratës nuk mund të jepen nga përfituesi palës së tretë pa ndonjë marrëveshje specifike nga AZHB. Në këso raste AZHB ka për detyrë që të mbikëqyrë në vazhdimësi mirëmbajtjen e pranueshmërisë dhe kriterëve përzgjedhëse.

NENI 7

NDËRPRERJA E KONTRATËS

- 7.1. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të justifikuar drejt, duke përfshirë ndikimin e "forcave madhore", pasi të diskutohet në mes të palëve, AZHB mund të vendosë që ta ndërpresë kontratën pa miratimin e përfituesit dhe ta kthejë mbështetjen e dhënë publike.
- 7.2. Palët mund të vendosin në ndërprerjen e Kontratës sipas një marrëveshjeje të përbashkët, në këtë rast përfituesi duhet ta kthejë të gjithë mbështetjen e marrë publike.
- 7.3. Në rast të vërejtjes së ndonjë parregullsie në ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë rastet kur përfituesi nuk është në gjendje të bëjë pagesën apo ka falimentuar, ose nëse është vërejtur se dokumentet e ofruara janë të rreme/skaduara/jo të plota/nuk pasqyrojnë realitetin, atëherë AZHB duhet ta ndërpresë kontratën në kuptimin e njoftimit me shkrim adresuar përfituesit, pa asnjë vonesë dhe pa asnjë formalitet tjetër. Në rast të tillë përfituesi duhet të kthejë tërë mbështetjen e marrë.
- 7.4. Në çdo kohë në rast të ndonjë dyshimi AZHB mund ta pezullojë përkohësisht kontratën dhe pagesat si masë paraprake deri në përfundim të hetimeve, pa ndonjë njoftim.

NENI 8

FORCA MADHORE

- 8.1. Sipas "forcës madhore", pala është e përjashtuar nga përgjegjësitë që parashihen me këtë kontratë.
- 8.2. Forca madhore është përcaktuar si një ngjarje e cila është e paparashikueshme dhe e pamundur për t'u shmangur nga palët, dhe që pengon kontratën për t'u ekzekutuar.
- 8.3. Si forcë madhore mund të konsiderohen rastet siç janë: tërmetet, vërshimet, embargot etj.
- 8.4. Çdo rast që dëshmohet të jetë forcë madhore, duhet të faktohet dhe pranohet nga AZHB.

NENI 9

KOMUNIKIMI MES PALËVE

- 9.1. Çdo këmbim i informatës në lidhje me këtë kontratë duhet të jetë në formë të shkruar: direkt, me e - mail ose faks.
- 9.2. Njoftimet verbale nuk do të merren parasysh nëse nuk janë përcjellë edhe me njoftime në formë të shkruar, siç është cekur në nenin 9.1.

Nënshkruar nga përfaqësuesi i AZHB-së

Nënshkruar nga Përfituesi
ose përfaqësuesi i tij ligjor

Emri dhe Mbiemri

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Data /__ /__ /_____

Data /__ /__ /_____

PJESË E KONTRATËS

PROCEDURAT E PROKURIMIT

(të jenë të bashkangjitura me kontratën e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor për përfituesit)

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR TË GJITHA LLOJET E BLERJEVE

- ▶ Të gjithë ofertuesit /tenderuesit duhet të plotësojnë Rregullën e origjinës - për detaje shih dispozitat dhe shtojcat e tjera relevante në Udhëzuesin e Aplikuesit;
- ▶ Asnjë nënkontraktues nuk mund të krijojë marrëdhënie kontraktuese në mes të ndonjë nënkontraktuesi tjetër dhe përfituesit;
- ▶ Blerjet duhet të respektojnë investimet që përmbushin kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në kuadër të masave dhe udhëzimeve të planit të biznesit psh. për sa i përket kthimit të investimeve, rrjedhës së parasë etj.
- ▶ Procedurat e prokurimit vlejné vetëm për investimet e pranueshme, për investimet e papranueshme nuk janë të obligueshme procedurat e prokurimit;
- ▶ Ka 3 lloje të procedurave: blerjet e drejtpërdrejta, blerjet me më së paku 3 oferta dhe përzgjedhje bazuar në prokurimin me shpallje publike (tender i hapur);
- ▶ Procedura për blerjet që do të aplikohen është në varësi të vlerës së blerjeve; është e ndaluar ndarja e blerjeve për llojin e njëjtë të mallrave, punimeve apo shërbimeve me qëllim të shmangies së rregullave procedurale të aplikueshme për një prag më të lartë;
- ▶ Ofertuesit nuk duhet të jetë në konflikt të interesit;
- ▶ Në rastin e shtrembërimit të informacionit të kërkuar nga përfituesi ose dështojné për të dhënë këtë informacion, ofertuesit do të përjashtohen nga dhënia e kontratave;
- ▶ Respektimi i rregullave të prokurimit është një kusht i detyrueshëm për t'u pranuar shpenzimet. Prandaj, dosja e kërkesës duhet të përmbajë dokumentet e pagesave për të provuar plotësimin e procedurave të prokurimit, si në Shtojcën 5 të kontrates.

2. KRITERET E DHËNIES / SHPËRBLYESE:

Kontratat duhet të jepen si më poshtë:

- A. Në rast të furnizimit / mallrave - të bazuar në çmimin më të ulët;
- B. Në rastin e Ndërtimit (nënkupton rezultatin e ndërtimit ose projektit të inxhinierisë civile që vetvetiu është e mjaftueshme të plotësojë një funksion ekonomik ose teknik dhe mbulon të dyja edhe ekzekutimin dhe dizajnimin) - bazuar në çmimin më të ulët;
- C. Në rast të shërbimeve (studime ose për ndihmë teknike) - bazuar në çmimin më të ulët;

3. PËRKUFIZIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

- ▶ Ekzistimi i lidhjeve ndërmjet përfituesit dhe furnizuesit (të afërmit, apo aksionarë të përbashkët në kompanitë ofertuese) ose në mes të anëtarëve të komitetit vlerësues.
- ▶ Pronësia e përbashkët (si individë ose si aksionarë) në mesin e furnizuesve të cilët dorëzojnë oferta.

4. PROCEDURAT E BLERJES:

4.1. BLERJET DIREKTE DERI NË 10 000.00 EURO.

Rregullat:

- ▶ Përfituesi mund të blejë drejtpërdrejt nga tregu,
- ▶ Kostoja e blerjes duhet t'i respektojë pragjet e vendosura në masë,
- ▶ Nuk ka nevojë për një kontratë të nënshkruar mes shfrytëzuesit dhe furnizuesit, përveç në rast të shpenzimeve të konsulencës,
- ▶ Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

4.2. PËRZGJEDHJA E BAZUAR NË TË PAKTËN 3 OFERTA DUKE FILLUAR NGA VLERA 10 000.01 EURO DERI NË 60 000.00 EURO.

Rregullat:

- ▶ Blerjet mund të bëhet vetëm më së paku 3 oferta (kuotim i çmimit);
- ▶ Shpenzimet brenda ofertës duhet t'i respektojnë edhe pragjet e vendosura brenda masave;
- ▶ Në të gjitha rastet, duhet të nënshkruhet kontrata mes përfituesit dhe furnizuesit,
- ▶ Ftesat për oferta, ofertat dhe kontrata duhet të respektojnë dispozitat /detajet e të cilave janë paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe brenda planit të biznesit.
- ▶ Përfituesi duhet të dërgojë një ftesë për ofertë, duke respektuar një format standard, si në Shtojcën 1;
- ▶ Furnizuesit duhet ta regjistrojnë ofertën e tyre në regjistrin e hyrje / daljeve.
- ▶ Përfituesi duhet ta nënshkruajë deklaratën për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interes, si në Shtojcën 2.
- ▶ Ofertuesit duhet të nënshkruajnë deklaratën e tenderuesit të besueshëm, si në Shtojcën 3.
- ▶ Përfituesi do të vendosë për dhënien e kontratës ofertuesit me argumente;
- ▶ Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

4.3. PROKURIMI ME SHPALLJE PUBLIKE (TENDER I HAPUR) - DUKE FILLUAR NGA 60 000.01 EURO

Rregullat:

- ▶ Të gjitha dispozitat nga pika 4.2. duhet të respektohen;
